



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Vendim nr. 228/1, Datë 3.11.2020**

**“Mbi korigjimin e Vendimit Nr. 228, Datë 17.01.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Marsela Balili”**

<b>Pamela Qirko</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Etleda Çiftja</b>	<b>Relatore</b>
<b>Xhensila Pine</b>	<b>Anëtare</b>

Bazuar në nenin 112, të Kodit të Procedurave Administrative: “Korigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

- 1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

Trupi gjykues u mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes znj. Etleda Çiftja, për korigjimin gabimit material në Vendimin e subjektit të rivlerësimit Marsela Balili:

Në vendimin e arsyetuar të subjektit të rivlerësimit znj. Marsela Balili, i cili iu dërgua palëve respektive, subjektit të rivlerësimit, përfaqësuesve të ONM-së dhe Komisionerëve Publik, konstatova se në tekstin e vendimit konkretisht: pika 1.3; 1.5; 1.7 (faqe 7), pika 1.25; 1.26 (faqe 11), pika 1.35 (faqe 13), pika 7.2 (faqe 34), është bërë një gabim material në cilësimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit z. Aleksandër Plepi, është shkruar “person tjetër i lidhur”, ndërkohë duhet të jetë “person i lidhur”.

Trupi pasi konstatoi se kërkesa e relatorit qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e një gabimi material,

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin e arsyetuar të subjektit të rivlerësimit znj. Marsela Balili, i cili iu dërgua palëve respektive, subjektit të rivlerësimit, përfaqësuesve të ONM-së dhe Komisionerëve Publik, konstatova se në tekstin e vendimit konkretisht: pika 1.3; 1.5; 1.7 (faqe 7), pika 1.25; 1.26 (faqe 11), pika 1.35 (faqe 13), pika 7.2 (faqe 34), është bërë

- një gabim material në cilësimin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit z. Aleksandër Plepi, është shkruar “person tjetër i lidhur”, ndërkohë duhet të jetë “person i lidhur”.
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korigjim.
  3. Vendimi i korigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda Çiftja**

**Relatore**

**Pamela Qirko**

**Kryesuese**

**Xhensila Pine**

**Anëtare**

Sekretare gjyqesore  
Olsida Goxhaj